

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 31.08.2023
PRIMLJENO:
Nr.Nc.Br. 02 / 417

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 14.08.2023

Në bazë të nenit 4, nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenin 14, nenit 16, nenin 17 paragrafi 1 shkronja (c), nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008”, në mbështetje të nenit 24 paragrafi 2 dhe nenit 25 paragrafi 3 dhe nën paragrafi 3.1 dhe 3.2, paragrafi 5, të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03, Prill 2019”, nenit 29, të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 29 par. 29.3 neni 31 nenit 19 paragrafi 7 pika a, nenit 46, të Statutit të Komunës së Malishevës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.07.2022 dhe vazhdimin e të njëjtës me datë 14.08.2023, miraton këtë:

V E N D I M

1. *Miratohet kërkesa, nr.01/940 e datës, 05.07.2023,parashtruar nga kryetari i komunës së Malishevës, për këmbimin e pronës publike me pronë private.*

2. Prona e paluajtshme komunale, e propozuar dhe miratuar për këmbim gjendet në zonën *kadastrale në Malishevë, Komuna e Malishevës*, me këto karakteristika;

2.1. Parcelën nr.72310047-01434-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 25347 m² vendin e quajtur “ Fusha te Ura “ me kulturë Lum, në emër të “ P.sh. Ujërat “ Zona Kadastrale në Malishevë.

2.2 Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim është pjesa e parcelës në *sipërfaqe prej 5 m²*, nga parcela nr. P-72310047-00970-2, zona kadastrale Malishevë, në bashkëpronësi 1/3 të z.Hajrë Islam Mazreku, Januz Islam Mazreku dhe Enver Islam Mazreku, dhe *sipërfaqja prej 50 m²*, në pjesën e parcelës, nr. P-72310047-00969-0, në pronësi private 1/2 të bashkëpronarëve, *Rabishe Brahim Mazreku dhe Bajram Selman Mazreku* nga Malisheva, KK- Malishevës.

2.3 Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për realizimin e projekteve kapitale për zgjerimin e hapësirave publike, për zgjerimin dhe rregullimin e trotuarit, urës dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse, për nevojat e komunë së Malishevës.

3. Këmbimi do të bëhet vetëm pas vlerësimit dhe raportit të vlerësimit, konform dispozitës së paraparë me nenin 30 të Rregullores (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

4. Para shpalljes publike të vendimit do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronave private, nga Departamenti i Tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe evidentohet në mes të kryetarit të komunës dhe pronarëve të pronarëve (bashkëpronarëve) të parcelave që do të këmbëhet. Këmbimi i cekur në pikën 2 të këtij vendimi do të publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve me të dhënat e pronave të këmbyera, vlerën e tyre si dhe emrat e pronarëve me të cilët do të bëhet këmbimi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Shërbim Pronëso-ro-Juridik

7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: skica grafike, kopjet e planit, certifikatat e njësisë kadastrale.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

*-U vendos nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, në vazhdimin e seancës së mbajtur me datë,
14.08.2023.-*

Vendimi ju dërgohet:

- 1.MAPL-së,
- 2.Palëve,
3. Drejtorive kompetente,
- 4.Arkivit të Komunës



" Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sqaron se Ligji nr.06/L-092, për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës në nenin 25 parasheh këmbimin e pronës së pakujtshme të komunës ku personat fizik dhe juridik mund të bëjnë kërkesë për këmbimin e pronës së tyre me pronën e komunës ;

" Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës pronën e paluajtshme të komunës për këmbim. Pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës, kuvendi vendos mbi afrimin e secilës pronë të propozuar për këmbim, duke votuar për secilën pronë ndaras "

Mbi bazën e këtij shqyrtimi edhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër me shkresën nr.06/31, dt.2020, duke u bazuar në rilevimin e parcelave ka dhënë konkrete me numra të njësive kadastrale, mirëpo bazuar edhe dispozitat ligjore të Ligjit të cekur i ka paraqitur edhe pronat komunale të lira të cilat pas shqyrtimit nga organet përgjegjëse mund të propozohen për këmbim.

Të gjitha janë të bashkangjitura edhe kësaj kërkesë, sipas dokumentacioneve publike të përgatitura nga drejtoria për gjeodezi kadastër dhe shërbim pronëso- juridik, në KK- Malishevës.

Në lidhje me këtë qështje jemi marrë edhe nëpërmjet gjykatës kompetente, si dhe në bazë të vlerësimeve të bëra sipas ekspertëve të përcaktuar nga gjykata, dëshmipërbilimi që duhet të paguaj komuna e Malishevës, në emër të pronarëve pronat e të cilëve janë dëmtuar dhe janë bërë të pa përdorshme, është e një shumnë e pa përballueshme për buxhetin e komunës, edhe pse prape zgjidhja nuk bëhet sepse dëmi do të vazhdon në mënyrë të permanente, andaj e vetmja zgjidhje është të këmbëhet kjo pronë në pajtim me ligjin dhe sipas vlerësimit të bërë nga organet kompetente të autorizuar me ligj.

Duke pritur shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës tonë, edhe një herë ju faleminderit për mirëkuptim!

Mirushë, 11.11.2022

Parashtruesit e kërkesës

1.Murtez Feriz Thaqi

2.Sahit Ademi Thaqi

3.Flurim Nezir Thaqi

Date		Time		Location		Remarks	
10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20
10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20

10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20
10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20
10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20	10/10/20

10/10/20

